



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 6383 Prot

Shkodër, më 20.3.2025

Lënda: Dërgim për shqyrtim relacioni dhe projekt vendimi mbi “ Rregulloren e përdorimit së hapësirës publike Bashkia Shkodër”.

KESHILLIT BASHKIAK SHKODER

Adresa : Rruga 13 Dhjetori, Nr.1



Të nderuar këshilltarë në mbështetje të dispozitave ligjore të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshua; VKM nr.408/201 “Për miratimin e rregullores dhe zhvillimit të territorit”, të ndryshuar; Ligjit nr.9632, date 30.10.2006 “Për Sistemin e taksave Vendore”, të ndryshuar; Ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”; të ndryshuar; Ligjit nr.68/2017, date 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesite e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; VKM nr.1096 date 28.12.2015 “Per miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike” , VKM 408 date 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”i ndryshuar , bashkangjitur ju paraqesim për shqyrtim relacionin dhe Projekt - Vendimin mbi “ Rregulloren e përdorimit së hapësirës publike Bashkia Shkodër”.

-Projekt Vendimi (2 flete)

-Relacioni (2 flete)

-Rregullorja (55 flete)

Duke ju falenderuar !

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

Z / KRYETAR

Alban FREKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETARI

Nr. ____ Prot

Shkodër, më _____.2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____, datë _____.2025

**“MIRATIMIN E RREGULLORES SË PËRDORIMIT TË HAPËSIRËS PUBLIKE
NË BASHKINË SHKODËR”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës ____/____/2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 54 shkronja “k”, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshua; VKM nr.408/201 “Për miratimin e rregullores dhe zhvillimit të territorit”, të ndryshuar; Ligjit nr.9632, date 30.10.2006 “Për Sistemin e taksave Vendore”, të ndryshuar; Ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”; të ndryshuar; Ligjit nr.68/2017, date 27.04.2017 “Për financat e veteqeverisjes vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; VKM nr.1096 date 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”, VKM 408 date 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar ;

VENDOSI :

1. Të miratojë rregulloren e përdorimit të hapësirës publike në bashkinë shkodër, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Shkodër.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 pas shpalljes.

KRYETAR

Benet BECI

Z/Kryetar

Alban Prëka



Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit
të Territorrit

A blue ink signature is written over a horizontal line.

Drejtorja e Kontrollit dhe zhvillimit
të territorit

ROBERT PIRO

Policia Bashkiake

A blue ink signature is written over a horizontal line.

Drejtorja e përgjithshme juridike, burimeve
njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse

A blue ink signature is written over a horizontal line.

Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore

A blue ink signature is written over a horizontal line.

Ndermarrja e Sherbimeve dhe Puneve Publike

A blue ink signature is written over a horizontal line.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.2025

RELACION

MBI "MIRATIMIN E RREGULLORES SË PËRDORIMIT TË HAPËSIRËS PUBLIKE NË BASHKINË SHKODËR"

Drejtuar: Këshillit Bashkiak, Shkodër

Të nderuar këshilltarë!

Bashkia Shkodër ka paraqitur materialin pranë Këshillit Bashkiak Shkodër, me objekt: Miratimin e rregullores së përdorimit të hapësirës publike në bashkinë Shkodër.

Në vijim të nevojave dhe problematikave të hasura në rregullimin e kuadrit ligjor mbi hapsirat publike , distancave të lejuara të shfrytëzimit të hapsirave publike , ekspozimit të mallrave jashta njësisë të tregtimit , shfrytëzimi të hapsirave me vendosjen e mundshme të kioskave , tabelave identifikuese ,tabelave reklamuese , reklamave, billBoards, hapësirave reklamuese të detikuara , hapsirave publike për vendosjen e biçikletave , si dhe kriteret mbi hapsirat e lejuara për parkim , mbi përcaktimin e kushteve dhe procedurave të detajuara për rregullat dhe kushtet e përdorimit të hapësirave publike në Bashkinë Shkodër , në mbështetje të dispozitave ligjore , parashikimeve të Planit të Pergjithshëm Vendor në fuqi në bashkinë Shkodër vleresojmë se kjo rregullore do realizojë kornizën e duhur tekniko-ligjore për menaxhimin , shfrytëzimin dhe përdorimin e hapësirës publike.

Sa më sipër theksojmë se qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve për një përdorim sa më uniform të hapësirës publike me qëllim krijimin e një mjedisi urban të rregullt dhe funksional në shërbim të komunitetit dhe sigurisë publike, nëpërmjet krijimit të një marrëdhënie transparente ndërmjet komunitetit dhe organeve autorizuese dhe inspektuese të Bashkisë Shkodër, me qëllim disponimin racional të burimeve të përbashkëta.

Rregullorja përcakton procedurat për dhënien e përdorimit të hapësirës publike, sipas kategorisë së aktivitetit , kriterëve të lejuara që do të ushtrohet nga subjektet e interesuara dhe pajisjeve,instalacioneve që do të lejohen të përdoren në një hapësirë publike të caktuar.

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; Ligjit nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshua; VKM nr.408/201 "Për miratimin e

rregullores dhe zhvillimit të territorit”, të ndryshuar; Ligjit nr.9632, date 30.10.2006 “Për Sistemin e taksave Vendore”, të ndryshuar; Ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”; të ndryshuar; Ligjit nr.68/2017, date 27.04.2017 “Për financat e veteqeverisjes vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesite e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; VKM nr.1096 date 28.12.2015 “Per miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike” , VKM 408 date 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”i ndryshuar ;

Së fundi propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë ”Rregulloren e përdorimit të hapësirës publike në bashkinë Shkodër”.

Duke ju falenderuar!

Z/Kryetar

Alban PREKA



Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit
burimeve të Territorrit

Arta Mashi

Drejtorja e Kontrollit dhe zhvillimit
të territorit

ROBERT PIRRO

Drejtorja e përgjithshme juridike,
njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse

Enis Neshi

Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore

Shota Blaci

Policia Bashkiake

Elan Duka

Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike

Albin Loxhi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

**RREGULLORJA
E
PËRDORIMIT SË HAPËSIRËS PUBLIKE
BASHKIA SHKODËR**

Baza ligjore :

Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”

Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar

Ligji Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar

Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e taksave Vendore”, të ndryshuar

Ligji Nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”; të ndryshuar

Ligji Nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar

Ligji Nr. Nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitet e qeverisjes vendore”, të ndryshuar

VKM. Nr.1096 datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”;

VKM 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”i ndryshuar.

Përmbajtja

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....	5
Neni 1 - Objekti dhe qëllimi	5
Neni 2 - Përkufizime	5
Neni 3 - Aktivitetet e lejuara në hapësirat publike	6
Neni 4 - Procedura e aplikimit dhe leja përkatëse	6
Neni 5 - Afati i lejes për përdorimin e hapësirës publike	7
Neni 6 - Pajisjet e lejuara, format, materialet dhe ngjyrat	7
Neni 7 - Ndalimet.....	7
Neni 8 - Mirëmbajtja dhe dëmtimet.....	8
Neni 9 - Kthimi i hapësirës publike	8
Neni 10 - Masat ndëshkuese	9
Neni 11 - Detyrimet financiare	10
Neni 12 - Të tjera	10
KREU I - PËRDORIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE NGA KATEGORIA E	
AKTIVITETEVE RESTORATIVE DHE/OSE REKREATIVE	11
Neni 13 - Leja për hapësirën publike	11
Neni 14 - Afati, dokumentacioni dhe procedura aplikimit	11
Neni 15 - Format e përdorimit së hapësirave publike.....	11
Neni 16 - Tipet e pajisjeve të lejuara	12
Neni 17 - Zënie e hapësirave publike me tavolina.....	12
Neni 18 - Tendat me strehë	13
Neni 19 - Tendat diellore	13
Neni 20 - Tenda me bimë kacavjerrëse	13
Neni 21 - Çadrat e diellit.....	14
Neni 22 - Saksitë/vazot dhe elementet kufizuese.....	14
Neni 23 - Pedanat, shtrojet dhe tapetet	15
Neni 24 - Erëpritëse	15
Neni 25 - Lojërat për fëmijë.....	16
Neni 26 - Te tjera	16
KREU II - DISTANCAT QË DUHET TË RESPEKTOHEN	17
Neni 27 - Distancat	17
Neni 28 - Hapësira publike/ trotuari pa Elemente Urban me përmasa nga 3.50m deri në 7.00m,	18
Neni 29 - Hapësira publike/ trotuari me përmasa nga 4.50m deri në 7.00m	19
Neni 30 - Hapësira publike/trotuari me përmasa më të mëdha se 7.00m	20
Neni 31 - Hapësira publike/trotuari me përmasa më të mëdha se 5.00m, në rrugë specifike	21
Neni 32 - Rrugë për këmbësorë/pedonale me përmasa më të mëdha se 5.00m.....	22
Neni 33 - Vendosja e elementeve specifike të hapësirave publike të rrethuara	23
Neni 34 - Hapësirat ku mund të vendosen pajisjet	24
Neni 35 - Përfundime dhe shprehjet e zbatimit të Kreu II	24
KREU III - EKSPLOZIMI I MALLRAVE JASHTË NJËSISË SË TREGTIMIT	25
Neni 36 - Leja dhe procedurat e dhënies së lejes	25

Neni 37 - Ekspozimi i mallrave	25
Neni 38 - Vendosja e pajisjeve	25
Neni 39 - Kriteret e distancave	25
Neni 40 - Lënia e lirë e hapësirës publike.....	27
Neni 41 - Detyrimet e subjektit.....	27
Neni 42 - Pezullimi i lejes.....	28
Neni 43 - Shkeljet	28
KREU IV - ZHVILLIMI I AKTIVITETIT TREGTAR NËPËRMJET VENDOSJES SË	
KIOSKAVE	29
Neni 44 - Kioskat	29
Neni 45 - Leja	29
Neni 46 - Procedura e ndjekur nga Bashkia Shkodër për përcaktimin e vendndodhjes së kioskave	29
Neni 47 - Dokumentacioni i kërkuar.....	30
Neni 48 - Procedura e aplikimit	30
Neni 49 - Kriteret të përgjithshme mbi vlerësimin e aplikimeve.....	30
Neni 50 - Kushtet dhe kriteret që i përmbahen subjektet gjatë ushtrimit të aktivitetit	31
KREU V - Elementet e fasadave të bazës së ndërtesave (Tabelat Identifikuese, Tabelat reklamuese , Reklammat, Elementet teknike dhe BillBoards)	32
Neni 51 - Kriteret të përgjithshme mbi vendosjen e tabelave identifikuese dhe reklamave	32
Neni 52 - Afati, dokumentacioni dhe procedura aplikimit	33
Neni 53 - Kriteret mbi vendosjen e elementeve teknike	33
KREU VI - PERDORIMI I HAPËSIRËS REKLAMUESE (CITY LIGHTS DHE TABELAT REKLAMUESE LED).....	35
Neni 54 - Leja dhe procedurat e dhënies së lejes	35
Neni 55 - Dimensionet dhe distancat	35
KREU VII – PARKIMET E AUTOMJETEVE.....	38
Neni 56 - Kriteret mbi Parkimet e Rezervuara të automjeteve	38
KREU VIII – PARKIMET E BIÇIKLETAVE	41
Neni 57 - Kriteret mbi vendosjen e Parkimeve të Biçikletave.....	41
Neni 58 - Autorizimi dhe procedura e dhënies së tij	42
KREU IX - DISPOZITA TË FUNDIT	43
Neni 59 - Strukturat zbatuese.....	43
Neni 60 - Njësia monitoruese	43
Neni 61 - Dispozita kalimtare	43
Neni 62 - Hyrja në fuqi	44
LIDHJA A.....	44
Neni 1 - Përcaktimet mbi çadrat e diellit që lejohen.....	44
Neni 2 - Përcaktimet mbi tendat me strehë dhe tendat diellore që lejohen.....	48
Neni 3 - Përcaktimet mbi saksitë/vazot dhe elementet kufizuese që lejohen	49
Neni 4 - Ekspozitorë produktesh ushqimore.....	53
Neni 5 - Biçikletat	55

DISPOZITA TË PËRSGJITHSHME

Neni 1 - Objekti dhe qëllimi

1. Kjo rregullore ka si objekt përcaktimin e kushteve dhe procedurave të detajuara për rregullat dhe kushtet e zënies/përdorimit të hapësirave publike në Bashkinë e Shkodrës.
2. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve për një përdorim sa më uniform të hapësirës publike me qëllim krijimin e një mjedisi urban të rregullt dhe funksional në shërbim të komunitetit dhe sigurisë publike, nëpërmjet krijimit të një marrëdhënie transparente ndërmjet komunitetit dhe organeve autorizuese dhe inspektuese të Bashkisë Shkodër, me qëllim disponimin racional të burimeve të përbashkëta.
3. Rregullorja përcakton procedurat për dhënien e përdorimit të hapësirës publike, sipas kategorisë së aktivitetit që do të ushtrohet nga subjekti/et e interesuar dhe pajisjeve që do të lejohen të përdoren në një hapësirë publike të caktuar.

Neni 2 - Përkufizime

Për qëllime të aplikimit të kësaj rregullore, termit e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Hapësirë publike”** është hapësira e jashtme, si trotuari, rruga, sheshi, lulishtja, parku e të tjera të ngjashme, në shërbim të komunitetit, ku menaxhimi mund të jetë publik dhe/ose privat, si dhe të gjitha ato pasuri që nuk janë të regjistruara në regjistrin e pasurive të paluajtshme në emër të subjekteve private”. Hapësira publike përfshin rrugëkalime publike dhe mjedise që janë të hapura për publikun ose në shërbim të përdorimit publik, pavarësisht nga regjimi juridik i tokës dhe përtej përcaktimeve të pronës publike, sipas ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar).
2. **“Shërbimet e lejuara”**, shërbimet që autoriteti vendor lejon të kryhen në hapësirë publike, sipas kategorive të lejuara të përdorimit të tokës, që përputhen me ndërtimet rreth hapësirës ku ato krijohen, sipas ligjit dhe dokumenteve të planifikimit.
3. **“Mobilimi urban”**, procesi i projektimit, ndërtimit dhe/ose vendosjes në hapësirë publike të objekteve apo ndërtimeve të lëvizshme ose jo, me qëllim përmirësimin e cilësisë funksionale dhe estetike të saj, rritjen e sigurisë publike dhe, sipas rastit, reduktimin e trafikut. Objektet e mobilimit urban përfshijnë vegjetacion, shtresat në sipërfaqen e hapësirave publike, stola, shatërvanë, instalime artistike, skulptura, tabela për emërtime të rrugëve apo reklamime, kabina telefonike, kosha për mbeturina, ndriçues, semaforë, trarë dhe objekte kufizimi të parkimit ose për ngadalësimin e automjeteve, kuti postare etj.
4. **“Aktivitete rekreative dhe restorative”**, përfshihen por pa u kufizuar aktivitete si, baret, restorantet, piceri, fast-food, hoteleri, si dhe çdo shërbim tjetër që ushtrohet në sektorin e shërbimeve sociale.
5. **“Kioskë”**, është një strukturë e vogël dhe pa themele, me materiale të çmontueshme, në të cilën shiten artikuj si pije, cigare dhe sende të tjera të ngjashme kinkalerie, përfshirë revistat apo gazetat.
6. **“Trotuar”**, është zona ndërmjet objekteve dhe karrexhatës që përdoret për aksesin e këmbësorëve. Gjërësia nga fasada e objektit deri në fundin e bordurës së trotuarit.
7. **“Bordura”**, është element i parë që ndan karrexhatën me trotuarin.
8. **“Element Urban”**, është zona në të cilën bëjnë pjesë elemente si pemë në krah të trotuarit, gjelbërim apo shkurre, koshat e mbeturinave, reklamën, ndriçuesit rrugor, stolat, vendqendrimet e biçikletave etj.

9. “Zonë Lëvizëse”, është hapësira publike që lejon kalimin e këmbësorëve në mënyrë lineare, paralel me karrexhatën dhe pa ndërprerje e cila duhet të jetë e lirë gjithmonë.

10. “Frontazhi”, është hapësira publike përpara fasadës së objektit ku ushtrohet aktiviteti ekonomik. Pajisjet e përcaktuara më lart duhet të vendosen brenda zonës së frontazhit për të cilën jepet leja.

11. “Njësi tregtimi” është ambienti i mbyllur njësi/dyqan në të cilin subjekti kryhen aktivitetin e tij. Njësitë e tregimit mund të jenë të shkëputura nga ndërtesa ose mund të përfshihet në të.

12. “Me pajisje”, kuptohen struktura metalike, plastike ose druri të cilat shërbejnë për ekspozimin e mallit përpara njësisë së tregimit.

Neni 3 - Aktivitetet e lejuara në hapësirat publike

Kategoritë e aktiviteteve që lejohen të ushtrohen/zhvillohen në hapësirat publike të Bashkisë janë:

- a) Ofrimi i shërbimeve restorative dhe rekreative (*si, por pa u kufizuar, në bare, restorante, fast-food, piceri, hoteleri e të ngjashme*);
- b) Ekspozimi i mallrave jashtë njësisë së tregimit.
- c) Hapësirat reklamuese (City Lights) dhe (Tabelat Reklamuese Led);
- d) Kioskat.

Neni 4 - Procedura e aplikimit dhe leja përkatëse

1. Çdo subjekt që kërkon të ushtrojë aktivitet në hapësirat publike duhet të pajiset me leje nga strukturat përkatëse të Bashkisë Shkodër.

2. Nëse subjekti kërkon leje për një hapësirë publike në një zonë me vlera monumentale, kjo leje do të lëshohet në bashkëpunim/bashkërendim me Institutin e Monumenteve të Kulturës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Paraprakisht duhet të merret konfirmimi/miratimi zyrtarisht nga i interesuari nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, (sipas dokumentacionit të nevojshëm) mbi sipërfaqen publike të cilën kërkon të perdori.

3. Afatet për shqyrtimin e kërkesave ndryshojnë në varësi të kategorisë së aktivitetit dhe lejes së kërkuar, por në çdo rast nuk tejkalohet afati 30 ditor nga momenti i marrjes së aplikimit.

4. Nëse gjatë shqyrtimit të aplikimit subjekti i interesuar ndryshon qëndrim, subjekti duhet t’ia komunikojë atë strukturës përkatëse në Bashkinë Shkodër brenda afatit të shqyrtimit të kërkesës.

5. Subjekti është i detyruar që lejen/kontratën e lëshuar nga Bashkia Shkodër ta ketë të vendosur në një vend të dukshëm në rastet kur kemi të bëjmë me zënie të hapësirës publike të qëndrueshme. Në të kundërt, të ketë lejen kurdoherë me vete nëse zënia e hapësirës publike kryhet në mënyrë jo të qëndrueshme.

7. Leja për ushtrimin e aktivitetit lëshohet në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje, si dhe dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë shfrytëzimit të hapësirës publike dhe pronës së paluajtshme të shtetit.

Neni 5 - Afati i lejes për përdorimin e hapësirës publike

1. Ushtrimi i aktivitetit në hapësirat publike është i përkohshëm. Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit përcaktohet në varësi të kategorisë së aktivitetit që subjekti kërkon të ushtrojë. Për disa kategori të caktuara ushtrimi i aktivitetit në hapësirën publike mund të jetë i kufizuar vetëm në ditë apo në orë të caktuara.
2. Afati maksimal për kohëzgjatjen e lejes për ushtrim aktiviteti nuk mund të jetë më shumë se 2 (dy) vjet.

Neni 6 - Pajisjet e lejuara, format, materialet dhe ngjyrat


1. Lejohet vetëm përdorimi i pajisjeve të përcaktuara në lejen/kontratën për zënien e hapësirës publike. Subjektet janë të lirë të zgjedhin format, materialet dhe ngjyrat e tyre sipas kesaj rregullore.
2. Pajisjet duhet të jenë lehtësisht të çmontueshme dhe nuk duhet të kenë pamje estetike të konsumuar/amortizuar dhe të çrregullt.
3. Në zona me rëndësi të veçantë social-kulturore apo ekonomiko-administrative, në të cilat synohet të kultivohet dhe ruhet një estetikë urbane uniforme, përdorimi i formave, materialeve dhe ngjyrave specifike për pajisjet nga subjektet e interesuar mund të përcaktohet me urdhër dhe vendime të titullarit të institucionit.
4. Nëse me akte ligjore të titullarit të institucionit ndryshojnë format, përmasat apo ngjyrat e pajisjeve në një zonë të caktuar, atëherë pajisjet duhet të ndryshohen sipas udhëzimeve të saj pa pasur nevojë për një leje të re. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit mbart detyrën e njoftimit ku kanë për detyrë t'ia komunikojë këtë subjekteve, ndërsa subjektet kanë për detyrë të bëjnë ndryshimet me shpenzimet e tyre në një kohe të caktuar por jo më shumë se 30 dite.

Neni 7 - Ndalimet

Ndalohet zënia/perdorimi i hapësirës publike në rastet kur:

1. Pengon qarkullimin normal të këmbësorëve dhe automjeteve dhe cenon sigurinë publike, në buzë të trotuarit që korrespondon me vazhdimin e vijave të bardha për lëvizjen e këmbësorëve;
2. Në ishujt e trafikut. Përjashtime bëjnë ato raste në të cilën kjo nuk përbën asnjë shqetësim për lëvizjen e këmbësorëve dhe atë të automjeteve;
3. Në vendndalimet dhe vendqëndrimet e përcaktuara për mjetet e transportit publik;
4. Në rastet kur bëhet pengesë për shikimin e sinjalistikës rrugore;
5. Dëmton/cënon dekorin e qytetit;
6. Nuk përmbush normat higjeno-sanitare;
7. Bie në kundërshtim me interesat e komunitetit;
8. Bie në kundërshtim me distancën e sigurisë nga stacionet e karburantit, që gjithsesi nuk mund të jetë më pak se 5 m distancë nga to.
9. Në vendet që ka monumente duhet lënë një hapësirë e nevojshme, e cila të mos e pengojë/cenoje shikimin vizual të plote të monumentit;
10. Në zonat me vlera historike me karakteristika të veçanta mund të jepet leje vetëm në rastet kur garantohej një lëvizje e lirë e këmbësorëve dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

11. Në kryqëzimet në të cilët nuk ka semaforë zënia e hapësirës publike mund të bëhet vetëm jashtë trekëndëshit të shikimit, pra të mos përbëjë asnjë vështirësi vizuale me qëllim sigurinë e lëvizjes së automjeteve, mjeteve pedaluese, kembësorve.



Neni 8 - Mirëmbajtja dhe dëmtimet

Subjekti, i cili është pajisur me leje për zënien e hapësirës publike, duhet:

1. Të garantojë një përdorim të sigurtë të hapësirës publike për kalimtarët, në përputhje me dekorin e qytetit dhe në gjendje perfekte higjeno-sanitare.
2. Të mirëmbajë pajisjet, të cilat duhet të jenë gjithnjë në rregull dhe të pastra dhe të mos të mbaj apo të vendosi apo ekspozojë asnjë send tjetër, përveç asaj të miratuar në lejen për ushtrim aktiviteti (*si kutia ambalazhi, etj*).
3. Të mbajë pajisjet në efikasitet të plotë, në rast të kundërt ndaj tij do të merren masa deri në anulimin e lejes së dhënë.
4. Çdo dëm që i shkaktohet hapësirës publike apo qytetarëve nga aktiviteti që zhvillohet, do t'i faturohet subjektit i cili është i pajisur me leje.

Dëmi ekonomik, si dëmtim në trotuar/infrastruktura, pemë apo hapësirën e gjelbër, vlerësohet nga strukturat përkatëse të bashkisë Shkodër mbi Sherbimet Publike, në përputhje me aktet ligjore të miratuara për këtë qëllim.

Neni 9 - Kthimi i hapësirës publike

1. Hapësira publike duhet të lihet e lirë nga çdo pajisje në rastet kur strukturat përkatëse të Bashkisë Shkodër duhet të kryejnë punime për interes publik, ose punime mirëmbajtje.
2. Struktura përkatëse e Bashkisë Shkodër e cila planifikon ndërhyrjen e investimit të paktën 10 ditë para fillimit të punimeve, duhet t'i komunikojë subjektit me shkrim datën në të cilën hapësira duhet lënë e lirë.
3. Kur hapësira publike duhet lënë e lirë në mënyrë urgjente (në rastet e ndërhyrjeve në interes publik emergjent), komunikimi nga ana e strukturave përkatëse mund të bëhet në mënyrë verbale duke konfirmuar në vijim e pa vonesë në formë të shkruar. Kur nuk është i mundur komunikimi verbal (*aktiviteti është mbyllur*), në këtë rast punonjësit e Policisë Bashkiake në

bashkëpunim me strukturat përkatëse të shërbimeve pranë Bashkisë Shkodër kryejnë lirimin e territorit dhe koston e punimeve ia faturojnë subjektit.

4. Hapësira publike duhet të kthehet në gjendjen e saj të mëparshme në rastet kur:

- a) subjekti nuk është i lejuar të ushtrojë aktivitetin;
- b) kalon data e përfundimit të lejes;
- c) anulohet leja/autorizimi.

5. Nëse lirimi i saj nuk bëhet nga vetë subjekti, Policia Bashkiake merr masa për lirimin e hapësirës publike dhe të gjitha shpenzimet për lirimin e saj i faturohen subjektit përgjegjës.

Lirimi i hapësirës publike mbështetet nga Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike për asistencën me mjete dhe burime njerëzore, si dhe Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore si informuese mbi fashat kohore të miratuara të hapësirave publike.

Neni 10 - Masat ndëshkuese

1. Në të gjitha rastet kur organet inspektuese konstatojnë shkelje nga subjekti i interesuar të kushteve të përcaktuara në lejen për zënie e hapësirës publike, ndaj subjektit të interesuar do të merren masat ndëshkuese, si më poshtë:

- a) Paralajmërim me shkrim/akt konstatimi;
- b) Gjohë;
- c) Pezullim;
- d) Shfuqizimi i lejes.

2. Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, konsiderohen shkelje:

- a) Zënia e hapësirave publike pa u pajisur më parë me lejen përkatëse;
- b) Ushtrimi i aktivitetit në një hapësirë më të madhe se ajo e përcaktuar në lejen që i është dhënë;
- c) Instalimi i pajisjeve për të cilat nuk përfshihen në lejen përkatëse;
- d) Kur mosmirëmbajtja e pajisjeve dëmton/cenon dekorin e qytetit ose përbën rrezik për jetën e qytetarëve;
- e) Subjekti nuk mban pastër hapësirën e cila i është lënë në dispozicion;
- f) Subjekti nuk paguan tarifën për përdorimin e hapësirës publike brenda afateve të përcaktuara në leje;
- g) Subjekti prish qetësinë publike apo ka sjellje të padenjë;
- h) Vazhdimi i aktivitetit edhe pas mbarimit të afatit të përcaktuar në leje apo anulimit;
- i) Kur zënia/përdorimi i kryer nuk është në përputhje me kriteret që janë përcaktuar në lejen e dhënë.
- j) Raste të tjera që nuk janë përfshirë në këtë nen, por që janë të parashikuara si shkelje ndaj hapësirës publike në akte të tjera ligjore/nënligjore në fuqi.

3. Për çdo shkelje të konstatuar apo dëmtim i hapësirës publike do të merret masa e ndëshkimit me gjohë sipas akteve ligjore, nënligjore dhe akteve të miratuara për këtë qëllim nga Këshilli Bashkiak apo Kryetari Bashkisë.

4. Për shkeljet e përsëritura dhe të gjobitura për më tepër se tre herë organi inspektues (Policia Bashkiake) merr masën e pezullimit të aktivitetit deri në korrigjimin e mangësive të konstatuara. Pezullimi jepet për një periudhë maksimale prej 30 ditë.

5. Nëse subjekti nuk ndërmerr masat e nevojshme për të korrigjuar mangësitë e konstatuara brenda periudhës së pezullimit, organi inspektues Policia Bashkiake fillon nisjen e procedurës për njoftimin e titullarit dhe hartimin e Urdhërit të pezullimit të kontratës së dhënë/lejes në bazë të konstatimeve të evidentuara.

6. Për secilën nga shkeljet e konstatuara masat ndëshkuese janë të integruara/kumulative, sipas natyrës dhe rëndësisë së shkeljes. Masat për çdo shkelje do merren sipas procedurave të ndjekura nga organet inspektuese konform kësaj rregullore dhe ligjeve në fuqi.

7. Organi inspektues Policia Bashkiake në rastet kur ka zënë abuzive urdhëron që subjekti të marrë masat për të lënë të lirë hapësirën publike brenda një afati 5 ditor. Nëse subjekti nuk respekton afatin, atëherë punonjësit e Policisë Bashkiake në bashkëpunim (nëse është e nevojshme) me inspektorët e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore , Ndërmarrja e Shërbimeve të Punëve Publike do të realizojnë procedurën për të liruuar hapësirën e zënë dhe shpenzimet për këtë i faturohen subjektit.

8. Aktet e kontrollit, të mbajtura gjatë inspektimit, ankimohen nga subjekti i interesuar në përputhje me Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” të cilat më pas i dërgohen për vlerësim Kryetarit të Bashkisë.

Neni 11 - Detyrimet financiare

1. Dhënia e çdo leje për zënie e hapësirës publike kushtëzohet nga pagesa e tarifës së përcaktuar “Për Taksat e Tarifave Vendore në Bashkinë Shkodër e cila varion në bazë të zonës në të cilën subjekti zhvillon aktivitetin e tij dhe sipërfaqen e hapësirës publike të zënë në “m²”.
2. Procedurat e pagesave bëhen pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Shkodër.

Neni 12 - Të tjera

1. Lejohet që subjekti të vendosë pajisje reklamuese për produktet ose shërbimet që ofron vetëm pasi ai të jetë pajisur me lejen përkatëse nga organi autorizues sipas dispozitave ligjore mbi kontrollin e territorit (ligj 107/2014 , VKM 408/2015).
2. Informacionet e nevojshme që do t'i shërbejnë subjekteve mbi kategoritë e aktiviteteve që zhvillohen në hapësirat publike ato mund t'i gjejnë në:
 - a) Në materialet promovuese;
 - b) Në buletine;
 - c) Në faqen e internetit të Bashkisë Shkodër.

KREU I - PERDORIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE NGA KATEGORIA E AKTIVITETEVE RESTORATIVE DHE/OSE REKREATIVE

Neni 13 - Leja për hapësirën publike

Subjekti që kërkon të shfrytëzojë hapësirën publike në funksion të zhvillimit të aktiviteteve restorative dhe/ose rekreative duhet të pajiset me kontratën përkatëse të shfrytëzimit të hapësirës publike si edhe me lejen perkatese per rastet kur punimet kerkojnë pajisjen me deklarata paraprake.

Neni 14 - Afati, dokumentacioni dhe procedura aplikimit

1. Afati maksimal i lejes për këto kategori aktiviteteve është 2 vjeçar. Me kërkesë të vetë subjektit kjo leje mund të lëshohet edhe për periudha sezonale, por në çdo rast jo më pak se një afat për 6 muaj.

2. Subjekti i interesuar duhet të paraqesë 30 ditë (koha maksimale e trajtimit të kërkesës) përpara periudhës së parashikuar nga ana e tij për hapjen e aktivitetit restorativ dhe/ose rekreativ kërkesën pranë Z1N, pranë Bashkisë Shkodër.

3. Subjektet aplikues, përveç dokumentacionit administrativ, duhet t'i përmbahen rregullave për plotësimin e dokumentacionit teknik/hartografik, që kanë të bëjnë me planvendosjen ose planimetritë dhe fotot e njësive ku ato zhvillojnë aktivitetin e tyre.

Për njësitë e hapura kërkohet:

a) Planimetria e hapësirës së kërkuar, e cila duhet ti përmbahet me rigorozitet parametrave të vendosura në këtë rregullore

b) Foto te gjendjes ekzistuese

Për njësitë e kufizuara kërkohen:

a) Planvendosja, planimetria dhe skicat duhet të jenë të punuara, të firmosura e vulosura nga persona të licencuar në fushën e projektimit dhe t'u përmbahen me rigorozitet parametrave të vendosura në këtë rregullore.

b) Pamje/Render ku te ilustruhet njësia e kufizuar

4. Afati i shqyrtimit të kërkesës është 15 ditë (pune) nga data e marrjes së aplikimit, por jo e kushtezuar në raste të veçanta për punime të cilat parashikohen sipas dispozitave ligjore të kontrollit të territorit por jo më shumë se 30 ditë.

5. Lejet për ushtrim aktiviteti jepet vetëm pasi janë marrë miratimet dhe autorizimet përkatëse për sa më sipër, si dhe në zbatim të legjislacionit të posaçëm në fuqi.

6. Leja për shfrytëzimin e hapësirës publike, së bashku me genplanin/planimetrinë, afishohet nga subjekti në një vend të dukshëm.

Neni 15 - Format e përdorimit të hapësirave publike

1. Aktivitetet restorative dhe/ose rekreative mund të zhvillohen në një nga format e mëposhtme:

a) Në hapësira publike të parrethuara (njësi e hapur);

- b) Në hapësira publike të rrethuara (*njësi e kufizuar*).
2. Në kuptim të këtij kreu të kësaj rregullore, me njësi të hapur kuptohet një hapësirë e pambyllur (*e parrethuar*), përpara lokalit dhe ku janë vendosur tavolina dhe karrige me qëllim shërbimin e pijeve, ushqimit apo ku janë vendosur lodra për fëmijët. Këto hapësira mund të kompletohen dhe me pajisje të tjera: tenda me strehë, çadra dielli dhe vazo.
3. Hapësira publike e parrethuar asnjëherë nuk mund të mbyllet me mjete të tjera të cilat nuk janë përcaktuar në lejen e lëshuar për zënien e hapësirës publike.
4. Me njësi të kufizuar, në kuptim të këtij kreu kuptohet një hapësirë ku janë vendosur tavolina dhe karrige me qëllim shërbimin e pijeve, ushqimit apo ku janë vendosur lodra për fëmijët dhe e cila është e rrethuar me mjete dekorative, erëpritëse e të tjera të ngjashme me to që nuk janë të përfshira në pikën 2.

Neni 16 - Tipet e pajisjeve të lejuara

1. Në hapësira publike të parrethuara, njësi e hapur, lejohen të vendosen pajisjet si më poshtë:
- a) Tavolina, karrige;
 - b) Çadra dielli;
 - c) Tenda me strehë;
 - d) Tenda diellore të mbyllshme;
 - e) Lojëra për fëmijë.
 - f) Saksi dhe elementë kufizues;
2. Në hapësira publike të rrethuara, njësi e kufizuar, përveç pajisjeve të sipërcituara lejohen të vendosen edhe ato si më poshtë:
- g) Tenda diellore;
 - h) Tenda me bimë kacavjerrëse;
 - i) Pedana dhe tapete;
 - j) Erëpritëse;
3. Kushtet dhe kriteret që zbatojnë subjektet që pajisen me lejen për zënien e hapësirës publike në lidhje me vendosjen e tipeve të ndryshme të pajisjeve në hapësirat publike janë të përcaktuara në nenet në vijim të këtij kreu.

Neni 17 - Zënie e hapësirave publike me tavolina

1. Përdorimi i hapësirës publike me tavolina dhe karrige, sipas kriterëve të lejes së lëshuar, bëhet si më poshtë:
- a) Zënia kryhet ngjitur me fasadën e godinës;
 - b) Zënia kryhet shkëputur nga fasada e godinës, mes elementeve urban;
 - c) Zënia kryhet shkëputur nga fasada e godinës.
 - d) Zënia kryhet në sheshe publike.
2. Pika b dhe c trajtohet vetëm me vendim të kryetarit të bashkisë.
3. Tavinat dhe karriget në asnjë rast nuk duhet të dalin jashtë hapësirës së përcaktuar në lejen e lëshuar për këtë qëllim.
4. Gjatë orarit të mbylljes, tavolinat dhe karriget duhet të largohen nga kjo hapësirë dhe të vendosen në mënyrë të rregullt në një zonë të caktuar, nëse kjo ndihmon itineraret e lëvizjes në zona të caktuara. Këto zona përcaktohen sipas urdhrave dhe vendimeve të Kryetarit të Bashkisë.

Kjo vlen vetem për rastet të cilat realizohen evente/festa me orare të përcaktuara dhe jo për bizneset të cilat ushtrojnë aktivitet bar,restorant etj.

5. Forma, materialet dhe ngjyrat e tavolinave janë në diskrecion të plotë të subjektit që pajiset me leje, përveç rasteve kur me urdhër dhe vendime të Kryetarit të Bashkisë përcaktohen rregulla të ndryshme e specifike për zonën të kushtezuara nga akte ligjore të tjera të cilat nuk përfshihen në këtë rregullore.

Neni 18 - Tendat me strehë

1. Tenda me strehë është struktura që përbëhet nga materiale sintetike apo pëlhura tekstili, të vendosura në pjesën e jashtme të njësisë, pa pikëmbështetje në truall, që shërbejnë për mbrojtjen nga dielli, reshjet e shiut apo shkaqe të tjera si pasojë e motit të keq.
2. Tendat duhet të vendosen për çdo vitrinë në mënyrë të veçantë. duke u përshtatur dhe me fasadën e ndërtesës. Tendat nuk duhet të jenë të puthitura me fasadën. Në rastin kur fasadat paraqesin veshje të veçanta në tullë, gurë ose materiale të tjera me vlerë, ndalohen instalimet që shkaktojnë tjetërsim të fasadës apo elementëve të dekorit.
3. Është i lejueshëm reklamimi pasi të jetë marrë autorizimi për këtë qëllim nga organi kompetent. Reklama duhet të vendoset në ekstremin e poshtëm të tendës me një madhësi të rregullt dhe të harmonizuar.
4. Gjatë periudhës së mbylljes së aktivitetit, tendat me strehë të cilat janë të dala më shumë se 1 m nga fasada nuk duhet të jenë të hapura.
5. Forma e tendës është në diskrecion të subjektit që pajiset me leje, përveç rasteve kur me akte të Kryetarit të Bashkisë përcaktohen rregulla të ndryshme dhe specifike për zonën. Materialet dhe ngjyrat e përdorura për tendën duhet ti përmbahen atyre të paraqitura në Lidhjen A.

Neni 19 - Tendat diellore

1. Tendat diellore janë struktura me mbulesë sintetike ose pëlhurë projektuar me pikëmbështetje mbi truall.
2. Tendat diellore nuk duhet të bllokojnë fushën e shikimit. Ndalohen të gjitha mbylljet ballore dhe anësore. Strukturat duhet të jenë rezistente ndaj erërave. Për këtë duhet të jenë të fiksuara mirë në truall në mënyrë që të mos përbëjnë asnjë rrezik për kalimtarët dhe të mos cenojnë sigurinë dhe jetën e njerëzve.
3. Me përjashtim të rasteve kur me akte të Kryetarit të Bashkisë përcaktohen rregulla të ndryshme e specifike për zonën, materialet dhe ngjyrat e përdorura për tendën duhet ti përmbahen atyre të paraqitura në Lidhjen A.
4. Në qendrat historike, për sa i përket ngjyrave, do të mbahen parasysh karakteristikat e veçanta të objektit në fjalë.

Neni 20 - Tenda me bimë kacavjerrëse

1. Tenda me bimë kacavjerrëse është struktura metalike ose druri me pikëmbështetje në truall e mbuluar me bimë kacavjerrëse.
2. Lartësia minimale e tendës me bimë kacavjerrëse nga trualli duhet të jetë 2.2 metra.

3. Kjo kategori tendash është e preferueshme të vendoset në sheshe, ku ajo mund të përshtatet shumë mirë nga ana dekorative.
4. Është e ndaluar që mbi ose nën bimët kacavjerrëse të vendoset një mbulesë tjetër sintetike apo pëlhure. Është i ndaluar ndërtimi e kësaj kategorie tendash me bimë helmuese.
5. Bimët duhet të jenë objekt i kujdesit të vazhdueshëm. Sipërfaqja e truallit mbi të cilin është vendosur tenda duhet të mbahet pastër nga gjethet.

Neni 21 - Çadrat e diellit

1. Çadra dielli janë strukturat mbajtëse me mbulesë beze të instaluar vetëm në një pikëmbështetje në truall.
2. Projektimi në truall i çadrave të diellit nuk duhet t'i kalojë limitet e sipërfaqes së dhënë në leje.
3. Lejohen shkrime publicitare, parashikuar në lejen e dhënë për reklamë, në pjesën e jashtme të çadrave. Këto reklama duhet të kenë një karakter të pranueshëm për zonën dhe ambientin ku do të vendosen këto çadra.
4. Çadrat diellore duhet të vendosen në bazamente të posaçme. Lartësia e telave të çadrës duhet të ketë një lartësi minimale prej 2.2 metra nga trualli.
5. Në rastet kur moti i keq shoqërohet me erëra të forta apo stuhi, çadrat diellore duhet të jenë të mbyllura, duke mos rrezikuar jetën dhe shëndetin e njerëzve. Gjatë natës, çadrat e diellit duhet të mbyllen ose të largohen nga hapësira publike e zënë.
6. Materialet dhe ngjyrat e përdorura për çadrat e diellit duhet ti përmbahen atyre të paraqitura në Lidhjen A.

Neni 22 - Saksitë/vazot dhe elementet kufizuese

1. Saksi/vazo do të konsiderohen elementët që shërbejnë për të kufizuar dhe dalluar hapësirat publike për të cilat subjekti është pajisur me leje përkatëse për të shfrytëzuar këtë hapësirë.
2. Kufizimi i sipërfaqes së zënë duhet gjithnjë të ndërtohet si një rresht elementësh. Nëse aplikanti përfiton dy hapësira/sipërfaqe të veçuara, këto duhet të kenë të njëjtët elementë kufizimi.
3. Vendosja e vazove apo saksive me qëllim zbukurimi dhe jo për qëllime kufizimi të një sipërfaqeje të caktuar, mund të lejohet vetëm, me kusht që të mbeten të lira zonat lëvizëse për kalimin dhe qarkullimin normal të këmbësorëve. Kufizimi nuk duhet të kalojë sipërfaqen e caktuar në leje.
4. Për të lejuar një hapësirë shikimi më të madhe, saksitë duhet të vendosen në mënyrë të tillë që ndërmjet tyre të ketë një hapësirë minimale sa gjysma e gjatësisë së një saksie.
5. Rrethimet nuk duhet të jenë në kontrast me karakteristikat arkitektonike të zonës. Në sipërfaqet këmbësore të qendrave historike të cilat mund të jenë të ngushta e të reduktuara, elementë të tillë kufizues mund të futen në një numër shumë të vogël.
6. Kur saksitë janë të vendosura:
 - a) si kufizues të sipërfaqes rrëzë murit të ndërtesës, lartësia e vazos nuk duhet të kalojë 0,6 m dhe lartësia përfshirë dhe bimën nuk duhet të kalojë 1.5m;
 - b) rrëzë murit me qëllim zbukurimi, lartësia e tyre është e lirë, gjerësia e vazos nuk duhet të kalojë 0,8 m dhe bimët nuk duhet të dalin jashtë vazos;
 - c) të gjitha tipet e tjera të rrethimit duhet të kenë një lartësi maksimale prej 1 m.
7. Saksitë nuk duhet të kenë mbishkrime reklamuese .

8. Vazot/saksitë duhet të mirëmbahen. Bimët duhet të jenë rezistente ndaj agjentëve të jashtëm dhe të mbajtura në gjendje të mirë. Nuk duhet të jenë të prishura apo të infektuara nga parazitët. Saksitë e lëna pas dore, të thyera, me bimë të kalbura duhet të hiqen nga subjektet që i kanë vendosur në të kundërt do të merren masa ndëshkimore.
9. Në rastet kur këto bimë janë të kalbura apo të pa mirëmbajtura organi inspektues (Policia Bashkiake) fillon nisjen e procedurës për njoftimin e titullarit dhe hartimin e Urdherit të pezullimit të kontratës/lejes së dhënë në bazë të konstatimeve të evidentuara deri në rivendosjen ose heqjen e tyre nga subjekti nga kjo hapësirë publike.
10. Mbështetjet në truall nuk duhet të pengojnë ose rrezikojnë qarkullimin e këmbësorëve dhe duhet të garantojnë një qëndrueshmëri të mirë të rrethimit.
11. Materialet dhe ngjyrat e përdorura për vazot dhe saksitë duhet ti përmbahen atyre të paraqitura në Lidhjen A.

Neni 23 - Pedanat, shtrojet dhe tapetet

1. Pedanat, shtrojet dhe tapetet janë elementë që vendosen direkt në sipërfaqen e shënuar. Ato janë të sheshta ose të ngritura në rastin e pedanave dhe kanë si funksion zbukurimin e ambientit në të cilin do të vendosen objektet e përcaktuara në leje. Këto lejohen vetëm në rastin e shesheve publik. Vendosja e tyre është e diskutueshme dhe varet nga karakteristikat specifike të zonës.
2. Ndalohet:
 - a) vendosja e pedanave, shtrojeve dhe tapeteve në trotuare publik;
 - b) mbulimi i kapakëve të pusetave, rrjetave të ajrimit dhe të tjera të ngjashme me to, prerja dhe ngjeshja e rrënjëve që dalin mbi sipërfaqe, apo çdo dëmtim dhe prishje trotuari.
3. Pedanat dhe elementët e mundshëm të vendosur për mbrojtje dhe kufizim nuk duhet të kalojnë përmasat e sipërfaqes së dhënë në leje.
4. Pedanat duhet të jenë me strukturë lehtësisht të çmontueshme dhe duhet të kenë një lartësi maksimale 15 cm nga trualli dhe duhet të përputhen me kriteret e përcaktuara në leje.
5. Tapetet nëse janë të veçuara, duhet të jenë të mbajtura në anët nga vazot apo saksitë në mënyrë që të mos pengojnë qarkullimin.

Neni 24 - Erëpritëse

1. Erëpritëse janë struktura komplekse, lehtësisht të çmontueshme dhe sezonale, me sipërfaqe të forta dhe transparente (*lartësia maksimale 3.0 m nga kuota e terrenit*) që shërbejnë për t'u mbrojtur nga era.
2. Struktura duhet të jetë e fiksuar në truall për çështje sigurie, por pa prishur shtresat e hapësirës publike (*pllakat, barin etj.*), lehtësisht e çmontueshme dhe struktura duhet të jetë brenda hapësirës së lejes së dhënë si dhe ajo nuk duhet të ndërhyjë në kuroren e pemëve.
3. Ndalohet përdorimi i çdo mjeti reklamues me përjashtim të një vetrofanie (*fletë e dizenuar me ngjyra, transparente, që vendoset mbi xham*) për secilën anë, që tregon emrin ose logon e aktivitetit, me përmasa jo më tepër se 10% të sipërfaqes totale të së njëjtës anë.
4. Në rastet kur erëpritëset janë prej materiali xhami, ato duhet të kenë një shtresë të brendshme e cila në rast thyerje të xhamit pengon rënien e copave të thyera për efekt sigurie.
5. Erëpritëset mund të mbajnë emrin ose logon e aktivitetit me kusht që përmasat të mos kalojnë 10% të sipërfaqes së tyre. Tipet e tjera të rrethimit nuk duhet të mbajnë asnjë lloj reklame tjetër.

Neni 25 - Lojërat për fëmijë

1. Lojëra për fëmijë do të konsiderohen strukturat komplekse, lehtësisht të çmontueshme, me sipërfaqe të fortë dhe lartësi maksimale 2.2 m nga trualli, që shërbejnë për të luajtur fëmijët e vegjël deri në moshën 12 vjeç.
2. Struktura duhet të jetë e fiksuar në truall për çështje sigurie, por pa prishur shtresat e hapësirës publike përreth dhe lehtësisht e çmontueshme. Struktura duhet të jetë brenda hapësirës së lejuar dhe nuk duhet të ndërhyjë në kurorën e pemëve. Hapësirat dhe sipërfaqja që mund të përdoret, përcaktohet duke ju referuar distancave të lejuara në nenin 26 e vijuese të Kreut II i kësaj rregullore.
3. Lojërat për fëmijë të përdorura në hapësirën publike duhet të kenë specifikime teknike dhe certifikatë sigurie me qëllim që të jenë të sigurta për fëmijët që do t'i përdorin.
4. Kur ato janë të vendosura në një sipërfaqe të fortë, të përdoret një shtresë në formë tapeti me sipërfaqe të butë për rritjen e sigurisë tek fëmijet për raste demtimi.
5. Tapeti i butë mbrojtës duhet të sigurojë parametrat termike, parametrat e zbutjes së goditjeve, të jetë material higjienik etj, ku të jenë të përcaktuara në specifikimet teknike të materialit të përdorur.

Neni 26 - Te tjera

Për zbatimin e nenit 17 pika 1 pika germa “c” të kësaj rregullore, pas miratimit përkatës për këtë hapësirë publike mund të vendosen për efekt hijezimi nga dielli të tavolinave të qëndrimit dhe instalacione të veçanta si bime/peme natyrore, peme në vazo, ose të ngjashme me lartësi me të vogla se 3 m, gjithmonë pa cënuar aspektin vizual dhe cënimit arkitekturor ku ndodhet hapësira publike e miratuar.

Zënia e hapësirës me këto instalacione të jetë minimaliste dhe mos të kalojë vlerën prej 5 % të sipërfaqes së hapësirës publike të dhëne.



KREU II - DISTANCAT QË DUHET TË RESPEKTOHEN

Neni 27 - Distancat

1. Në këtë kre përcaktohen kriteret për mënyrën e vendosjes së pajisjeve në hapësirën publike dhe distancat që duhet të respektohen me qëllim ruajtjen e zonave lëvizëse të këmbësorëve dhe unifikimin e përdorimit të tyre. Distancat e paraqitura në vijim aplikohen në të gjitha format e zënies së hapësirës publike dhe pajisjet e lejuara me qëllim zhvillimin e aktiviteteve restorative dhe/ose rekreative.

2. Distanca e Frontazhit përcaktohet në raport me dimensionet e hapësirës publike duke garantuar gjithmonë:

a) Zonën Lëvizëse, e cila nuk mund të jetë më pak se 2.00 m;

b) Elementin Urban, nëse ka, (përfshirë bordurën) i cili nuk mund të jetë më pak se 1.50 m,


3. Gjatësia e shtrirjes së frontazhit shtrihet jo më shumë se fasada e objektit ku subjekti ushtron aktivitetin.

Në rast se në momentin e aplikimit paraqitet edhe dakordësia noteriale e pronarëve të pronave bashkëngjitur për kohëzgjatjen për të cilën kërkohet përdorimi i hapësirës publike, duke përcaktuar hapësirën e hyrje/daljes, frontazhi mund të shtrihet edhe në gjatësinë e fasadës së këtyre pronave, por në çdo rast jo më shumë se 50 ml për një subjekt.




Neni 28 - Hapësira publike/ trotuari pa Elemente Urban me përmasa nga 3.50m deri në 7.00m,

1. Në rast së hapësira publike/trotuari është 3.50m, por pa Elemente Urban duhet të garantohej një Zonë Lëvizëse për këmbësorët + bordurë baraz me 2.50m.
2. Në këtë rast Frontazhi për subjektet është 1.00m dhe të gjithë elementët përbërës të tij (si p.sh. karrige, tavolina, saksitë, tendat etj) nuk duhet të kalojnë këtë distancë.
3. Në rast së hapësira publike/Trotuari është më e madhe se 3.50m por më e vogël se 7.00m, hapësira mbi 3.50m i jepet Frontazhit.
4. Trotuari duhet të jetë pa elemente urbane si peme, gjelbërim te ulet ose stola, në për një gjatësi të paktën 100m në mënyrë konsiderohet në kategorinë e përshkruar nga ky nen.




Neni 29 - Hapësira publike/ trotuari me përmasa nga 4.50m deri në 7.00m

1. Në rast së hapësira publike/trotuari është 4.50m duhet të garantohet një Zonë Lëvizëse për këmbësorët baraz me 2.00m, Elementi Urban + Bordura baraz me 1.50m.
2. Në këtë rast Frontazhi për subjektet është 1.00m dhe të gjithë elementët përbërës të tij (si p.sh. karrige, tavolina, saksitë, tendat etj) nuk duhet të kalojnë këtë distancë.
3. Në rast së hapësira publike/Trotuari është më e madhe se 4.50m por më e vogël se 7.00m, hapësira mbi 4.50m i jepet Frontazhit, deri në një maksimum prej 3.00m të këtij të fundit..




Neni 30 - Hapësira publike/trotuari me përmasa më të mëdha se 7.00m

1. Në rast se hapësira publike/trotuari është 7.00m, duhet të garantohej një Zonë Lëvizëse për këmbësorët baraz 2.50m, Elementi Urban + Bordura baraz me 1.50m.
2. Në këtë rast Frontazhi për subjektet është 3.00m dhe të gjithë elementët përbërës të tij (si p.sh. karrige, tavolina, saksitë, tendat etj) nuk duhet të kalojnë këtë distancë.
3. Në rast se hapësira publike/trotuari është më e madhe se 7.00m, hapësira mbi 7.00m i jepet zonës së Frontazhit, deri në një maksimum prej 6.00m të këtij të fundit.




Neni 31 - Hapësira publike/trotuari me përmasa më të mëdha se 5.00m, në rrugë specifike

1. Ky rast aplikohet vetëm kur me urdhër/vendim të kryetarit përcaktohet për rrugën specifike, se zënia e hapësirës publike mund të kryhet shkëputur nga fasada e godinës mes elementeve urban;
2. Kur hapësira publike/trotuari është 5.00m, duhet të garantohet një Zonë Lëvizëse për këmbësorët baraz me 3.00m përgjatë fasadës së ndërtesës, dhe kur përgjatë rrugës ka parkime automjesh, duhet të garantohet edhe një zonë lëvizëse + bordurë prej 0.60m për aksesin në to.
3. Në këtë rast Frontazhi për subjektet është 1.40m dhe të gjithë elementët përbërës të tij (si p.sh. karrige, tavolina, saksitë, tendat etj) nuk duhet të kalojnë këtë distancë.
4. Në rast se hapësira publike/trotuari është më e madhe se 5.00m, hapësira mbi 5.00m i jepet zonës së Frontazhit, deri në një maksimum prej 6.00m të këtij të fundit.



Neni 32 - Rrugë për këmbësorë/pedonale me përmasa më të mëdha se 5.00m

5. Ky rast aplikohet vetëm kur me urdhër/vendim të kryetarit përcaktohet për rrugën specifike,
6. Në rast se rruga pedonale është 5.00m, duhet të garantohet një Zonë Lëvizëse për këmbësorët baraz 3.00m.
7. Në këtë rast Frontazhi për subjektet është 1.00 m në dy anë dhe të gjithë elementët përbërës të tij (*si p.sh. karrige, tavolina, etj*) nuk duhet të kalojnë këtë distancë.
8. Në rast së hapësira publike është më e madhe se 5.00m, hapësira mbi 5.00m i jepet zonës së Frontazhit, dhe ndahet në mënyrë të barabartë në dy anët e rrugës, deri në një maksimum prej 6.00m të frontazhit.
9. Ky rast mund të aplikohet edhe për rrugët që funksionojnë si pedonale me orare të kufizuara.



Neni 33 - Vendosja e elementeve specifike të hapësira publike të rrethuara

1. Në hapësira publike të rrethuara (njësi e kufizuar), vendosja e pajisjeve:

- a.Tenda diellore;
- b.Tenda me bimë kacavjerrëse;
- c.Pedana/ tapete
- d.Erëpritëse

është e diskutueshme dhe varet nga karakteristikat specifike të zonës.

2. Këto elemente do të lejohen në rastet kur trotuari/sheshi paraqet zgjerime, xhepa, etj.

Në mënyrë specifike kur, përgjatë aksit ku kërkohet të vendoset njësia, ekziston një vijë ndërtimi në distance maksimale prej 40m, do të lejohet përdorimi i elementeve të njësive të kufizuara. Njësia e mbyllur duhet të ruajë distancën e kësaj vije nga bordura e trotuarit, por mund të jetë edhe më e vogël se kaq.

Rregulli i mësipërm do të përdoret në shqyrtimin e rasteve, në mënyrë që njësitë e rrethuara të ndikojnë pozitivisht në unifikimin e frontit urban në zonat e ndryshme të qytetit, duke mos cenuar në asnjë mënyrë zonat lëvizëse për këmbësoret.

3. Në të gjitha rastet duhet të respektohen distancat e përcaktuara në nenet 27-29 për gjerësinë e lirë të zonës lëvizëse.

4. Në rastin e zonave me projekte/rregullore të veçanta projekti mund të përcaktojë rregulla të ndryshme, specifike për zonën.

Neni 34 - Hapësirat ku mund të vendosen pajisjet

Hapësirat ku mund të vendosen pajisjet ilustrohen në skemën si më poshtë:

Tipet e pajisjeve										Lojëra për fëmijë
Tipet e zënive		Pajisje të pambuluara	Çadra dielli	Tenda me strehë	Tenda me bimë kacavjerrëse	Tenda diellore	Njësi mikse me erëprirëse	Pedana shtrojet tapetet	Saksi / vazo	
a	Në trotuare	☒	☒	☒		☐	☐	☐	☒	
b	Në sheshe	☐	☐	☐	☐			☐		☐
c	Në zona të tjera	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐
e	Në trotuaret / sheshet me vlera të veçanta	☐	☐	☐						

Përcaktime:

- ☒ Lejohet vendosja e tyre në të gjitha rastet që plotësojnë kushtet e rregullores.
- ☐ Vendosja e tyre është e diskutueshme dhe varet nga karakteristikat specifike të zonës.

Neni 35 - Përfashtime dhe shtrirja e zbatimit të Kreut II

1. Distanca të përcaktuara në nenin 26 e vijuese të Kreut II aplikohen në të gjitha rastet, përveç rasteve ku një itinerar lëvizje për arsye përdorimi të qëndrueshëm, të zgjatur në kohë, frekuencimit të rregullt dhe/ose intensiv ka fituar karakteristika identifikuese dhe përfaqësuese për një fashë të komunitet apo subkulturë urbane dhe popullaritet si pikë tubimi, socializmi dhe/ose shkëmbimi tematik.
2. Përfashtimet jepen me vendim të titullarit të institucionit të Bashkisë Shkodër, vetëm në mbështetje të dispozitave ligjore të cilat nuk përmenden në këtë rregullore.
3. Përfashtim nga parashikimet e mësipërme për pajisjen me leje sipas rregullave të përcaktuara në këtë kre mund të aplikohen për institucionet financiare, si dhe të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari për të cilat është e detyrueshme pajisja dhe mbajtja në gjendje pune e një gjeneratori.
4. Subjektet, të cilët ushtrojnë aktivitet në hapësira me funksion publik në pronësi private duhet të pajisen me leje për ushtrimin e aktivitetit, por janë të përfashtuar nga zbatimi i vendimit të Këshillit Bashkiak "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë së Shkodrës" (i ndryshuar), për tarifën e zënies së hapësirës publike. Subjektet i nënshtrohen të gjitha detyrimeve të tjera të përcaktuara në këtë kre në lidhje me distancat.
5. Subjekti privat duhet të vërtetojë titullin e pronësisë nëpërmjet paraqitjes së dokumentit/vertetimit të pronësisë të tre muajve të fundit (prane Agjencia Shtetërore e Kadastres).

KREU III - EKSPOZIMI I MALLRAVE JASHTË NJËSISË SË TREGTIMIT

Neni 36 - Leja dhe procedurat e dhënies së lejes

1. Në këtë kre përcaktohen rregullat për mënyrën e ekspozimit të mallrave jashtë njësisë së tregtimit dhe pajisjen e tregtarëve me lejen përkatëse.
2. Çdo subjekt që kërkon të ushtrojë aktivitetin e tij të ekspozimit të mallrave jashtë njësisë së tregtimit duhet që të pajiset me kontratën përkatëse sipas sipërfaqes së deklaruar nga subjekti.
3. Ekspozimi i mallit jashtë njësisë së tregtimit pa lejen/kontratën përkatëse do të konsiderohet shkelje dhe mbi subjektin do të merren masa ndëshkuese.
4. Leja/kontrata do të lëshohet me një afat maksimal 2 vjeçar, por sipas kërkesës së vetë subjektit ky afat mund të jetë edhe për periudha sezonale jo më pak se 6 muaj.
5. Subjekti i interesuar duhet të paraqesë dokumentacionin pranë Z1N, bashkia Shkodër.
6. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin e plotë të përcaktuar në formularin e aplikimit pranë Z1N.
7. Afati i shqyrtimit të kërkesës nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në koordinim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore është 15 ditë nga data e marrjes së aplikimit.

Neni 37 - Ekspozimi i mallrave

1. Çdo subjekt që është i pajisur me leje për ushtrimin e aktivitetit për ekspozimin e mallrave jashtë njësisë së tregtimit, mund të ekspozojë vetëm këtë kategori mallrash jashtë saj:
 - a) Fruta – perime;
 - b) Lule;
 - c) Libra.
 - d) Suvenir (jo që përfshijne veshje)


Neni 38 - Vendosja e pajisjeve

1. Për vendosjen e pajisjeve jashtë njësisë së tregtimit, mbahen parasysh këto kritere dhe distanca:
 - a) Pajisjet nuk duhen të jenë të fiksuara, si në tokë ashtu dhe në fasadën e ndërtesës;
 - b) Pajisjet duhet të jenë funksionale, të kenë një paraqitje të mirë estetike dhe të jenë të çmontueshme;
 - c) Për pajisjet me shtrirje vertikale distanca ndërmjet fasadës së ndërtesës ku ushtrohet aktiviteti dhe pjesës më ekstreme të pajisjes që shërben për të ekspozuar mallrat nuk duhet të jetë më e madhe se 1 metër;
 - d) Lartësia e pajisjes nga toka nuk duhet të jetë më e lartë se 1.2 metër.Për kategoritë e mallrave Fruta – perime, subjektet duhet ti përmbahen tipologjive të përcaktuara në Aneksin A.


Neni 39 - Kriteret e distancave



1. Në rast se hapësira publike/trotuari është 3.50m pa Elemente Urbane, duhet të garantohet një Zonë Lëvizëse për këmbësorët + bordurë baraz me 2.50m. Frontazhi për subjektet është 1.00m dhe të gjithë elementët përbërës të tij nuk duhet të kalojnë këtë distancë. Në rast se hapësira publike/Trotuari është më e madhe se 3.50m, hapësira mbi 3.50m i lihet Zonës Lëvizëse. Trotuari duhet të jetë pa elemente urbane si peme, gjelbërim të ulët ose stola në për një gjatësi të paktën 100m në mënyrë konsiderohet në këtë kategori.



2. Në rast se hapësira publike/trotuari është 5.00m duhet të garantohej një Zonë Lëvizëse për këmbësorët baraz me 2.50m, Elementi Urban + Bordura baraz me 1.50m. Frontazhi për subjektet është 1.00 m dhe të gjithë elementët përbërës të tij nuk duhet të kalojnë këtë distancë. Në rast se hapësira publike/Trotuari është më e madhe se 5.00m hapësira mbi 5.00m i lihet Zonës Lëvizëse.



Neni 40 - Lënia e lirë e hapësirës publike

Pajisjet do të jenë të vendosura vetëm gjatë orëve të zhvillimit të aktivitetit. Në të gjitha rastet kur njësia do të jetë e mbyllur ato detyrimisht duhet të hiqen duke lënë totalisht hapësirën të lirë.

Neni 41 - Detyrimet e subjektit

Subjekti ka për detyrë të mbajë pastër hapësirën publike në të cilën zhvillon aktivitetin e ekspozimit për të cilin i është lëshuar leja.
Subjekti duhet të mirëmbajë pajisjet të cilat i shfrytëzon për të ekspozuar mallrat.
Subjekti në asnjë rast nuk duhet të hedhë përtokë mbeturina apo mbetje të çfarëdo lloji, por duhet t'i grumbullojë ato në vendet e caktuara për këtë qëllim.



Neni 42 - Pezullimi i lejes

Subjektit i pezullohet miratimi/kontrata përkohësisht në rastet kur në hapësirën publike të lënë në dispozicion për t'u shfrytëzuar nga ai duhen të kryhen punime për interes të publik.

Neni 43 - Shkeljet

1. Përveç shkeljeve të përcaktuara në Kreun I, neni 10, pika 2 të kësaj rregullore për shkak të specifikave të aktivitetit konsiderohen shkelje dhe rastet në vijim:

- a) Ekspozon mallra të ndryshëm nga ato të përcaktuar në lejen me të cilën është pajisur;
- b) Aktiviteti është mbyllur dhe ai nuk ka larguar pajisjet nga zona (jashta fashes orare 08.00-24.00).

2. Në këtë rast organi inspektues vepron në përputhje me parashikimet e Kreut I, neni 10, pikat 3, 4, 5 dhe 6 e kësaj rregullore.

KREU IV - ZHVILLIMI I AKTIVITETIT TREGTAR NËPËRMJET VENDOSJES SË KIOSKAVE

Neni 44 - Kioskat

1. Në këtë kre të rregullores përcaktohen rregullat për pajisjen e subjekteve me leje për zhvillimin e aktivitetit të tyre nëpërmjet vendosjes së kioskave në hapësirat publike të Bashkisë Shkodër.
2. Me ushtrim aktiviteti nëpërmjet vendosjes së kioskave kuptohet tregtimi i përditshëm i suvenireve, kinkalerive, pijeve freskuese e ushqimeve fast-food, produkteve të duhanit, biletari të autobusit, si edhe sendeve të tjera të këtij lloji.
3. Kioskat duhet të jenë të parafabrikuara dhe me strukturë të qëndrueshme, por të cilat në asnjë rast nuk duhet të dëmtojnë hapësirën publike në të cilat vendosen dhe hapësirën përreth saj.
4. Pavarësisht karakteristikave specifike, kioskat duhet të përshtaten dhe të harmonizohen me mobilimin urban të zonës dhe ambientin përreth. Në rastin e subjekteve që kërkojnë të vendosin një rrjet kioskash, ato duhet të kenë të njëjtat karakteristika dhe të njëjtën tipologji tregtimi.
5. Vendosja e elementeve reklamues në kioska lejohet për një sipërfaqe jo më shumë se 1 m² reklame. Me tejkalimin e kësaj sipërfaqe do të taksohet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 45 - Leja

1. Çdo subjekt që kërkon të shfrytëzojë hapësirën publike në funksion të zhvillimit të aktivitetit tregtar nëpërmjet vendosjes së kioskave, duhet që më parë të pajiset me lejen përkatëse nga Bashkia Shkodër, sipas përcaktimeve në këtë rregullore.
2. Leja e lëshuar nga Bashkia Shkodër është personale/unike dhe e patransferueshme tek çdo person/subjekt tjetër.
3. Për qëllime të interesit publik apo sigurisë dhe shëndetit të njerëzve, lejet janë të revokueshme nga Bashkia Shkodër në çdo moment.
4. Leja ka afat minimal 1 vjeçar dhe maksimal 2 vjeçar dhe mund të rinovohet në përfundim të këtij afati, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore.
5. Leja lëshohet vetëm pasi subjekti të jetë pajisur me të gjitha lejet dhe licencat përkatëse për zhvillimin e aktivitetit dhe për vendosjen dhe montimin e kioskës.
6. Në rastin kur subjekti pajiset me leje për vendosjen e kioskës, marrëdhënia midis Bashkisë Shkodër dhe subjektit, përveç lejes shoqërohet edhe me një kontratë bashkëpunimi mbi detyrimet dhe të drejtat e palëve.
7. Pas pajisjes me leje për vendosjen e kioskave, subjekti duhet të marrë miratimin përkatës në përputhje me rregullat dhe kushtet për zhvillimin e territorit.

Neni 46 - Procedura e ndjekur nga Bashkia Shkodër për përcaktimin e vendndodhjes së kioskave

1. Bashkia Shkodër, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, nisur nga nevoja dhe domosdoshmëria e ofrimit të shërbimeve, miraton vendosjen e kioskave në hapësirën publike të qytetit.

2. Rregullat, kushtet dhe tipologjia e kioskave përcaktohen në aktet e miratuara nga Kryetari i Bashkisë. Vendndodhja e tyre mund të përcaktohet edhe në Planet e Detajuara Vendore apo në dokumentat e tjera të planifikimit që miratohen nga strukturat përgjegjëse, në përputhje me akte ligjore dhe nënligjore që normojnë zhvillimin dhe planifikimin e territorit.

3. Kioskat mund të vendosen dhe të jenë të integruara edhe në stacionet e autobusave urban të qytetit sipas projekt ideve dhe vendimarrjeve të bashkisë Shkodër.

Neni 47 - Dokumentacioni i kërkuar

1. Në njoftimin publik të Bashkisë Shkodër për aplikimin e subjekteve të interesuara për të ushtruar aktivitetin e tyre tregtar nëpërmjet pajisjes me leje për zënien e hapësirës publike me vendosjen e kioskës/ave, përcaktohet edhe dokumentacioni i kërkuar, i cili minimalisht duhet të përmbaj:

a) Kërkesën e subjektit aplikues;

b) Certifikatën e regjistrimit dhe certifikatën historike të regjistrimit të subjektit në Qendrën Kombëtare të Biznesit;

c) NUIS-in dhe vërtetimin nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore apo që nuk ka detyrime të tilla;

Neni 48 - Procedura e aplikimit

1. Kushdo ka të drejtë të aplikojë për t'u pajisur me leje për ushtrimin e tregtisë nëpërmjet vendosjes së kioskave, vendndodhja e të cilave është miratuar më parë nga Bashkia Shkodër.

2. Çdo subjekt juridik apo fizik, duhet të gëzojë zotësi juridike për të vepruar dhe të jetë i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

3. Personi/subjekti i interesuar duhet të paraqesë pranë Qendrës së Regjistrimit të Licencave Shkodër, kërkesën për të ushtruar aktivitetin tregtar nëpërmjet vendosjes së kioskave. Kërkesa, shoqërohet së bashku me dokumentacionin e plotë të përcaktuar në formularin e aplikimit.

4. Paraqitja e kërkesës, si rregull bëhet çdo fillim vit, pasi Bashkia Shkodër të ketë shpallur publikisht numrin e vendeve dhe vendndodhjen për vendosjen e kioskave në hapësirën publike të saj. Në rastin e rinovimit të lejes, kërkesa paraqitet 30 ditë para përfundimit të saj.

5. Vendndodhja e përcaktuar nga Bashkia Shkodër mund të ndryshojë pas lejes së dhënë, për shkak të cenimit të interesit publik apo shëndetit dhe jetës së njerëzve apo me marrëveshje midis Bashkisë Shkodër dhe subjektit që ushtron aktivitetin.

6. Shqyrtimi i kërkesës ka për qëllim të verifikojë vendndodhjen, listën e produkteve që do të tregtohen, strukturën, renderat dhe dizajnin e kioskës që do të vendoset, materialet e përdorura, ngjyrat dhe logot, të cilat duhet të jenë në harmoni me funksionin dhe estetikën e hapësirës publike në të cilën do të vendosen.

7. Afati i shqyrtimit të kërkesës nga organet autorizuese është 15 ditë nga data e marrjes së aplikimit.

8. Në miratimin e kërkesës për plotësimin e vendeve për ushtrimin e aktivitetit nëpërmjet vendosjes së kioskave ndiqen në mënyrë transparente plotësimi i kushteve për çdo aplikim.

Neni 49 - Kriteria të përgjithshme mbi vlerësimin e aplikimeve

1. Në vlerësim e aplikimeve të paraqitura nga subjektet private, u jepet përparësi, kriterëve si më poshtë:

a) Plotësimi i dokumentacionit të kërkuar;

- b) Numrit të punonjësve që synohet të punësohen;
- c) Punësimi i personave të përfshirë në skemat e përkrahjes sociale që përfitojnë nga Bashkia Shkodër;
- d) Ofrimin falas të shërbimeve publike për qytetin dhe komunitetin për llogari të Bashkisë Shkodër;
- e) Kryerjen e punimeve nëpërmjet sponsorizimit/dhurimit për përmirësimin e infrastrukturës publike në favor të Bashkisë Shkodër;
- f) Data e paraqitjes së kërkesës.
- g) Oferta financiare e paraqitur nga subjekti.

Neni 50 - Kushtet dhe kriteret që i përmbahen subjektet gjatë ushtrimit të aktivitetit

Subjektet që kryejnë aktivitetin e tyre nëpërmjet vendosjes së kioskave në hapësirat publike, duhet të përmbushin kushtet e përcaktuara më poshtë:

1. Të mos zënë sipërfaqe më të mëdha se ajo e miratuar në lejen për zënie hapësirës publike.
2. Mallrat duhet të ekspozohen dhe të tregtohen vetëm në ambientet e brendshme të kioskave, me përjashtim të gazetave dhe shtypit të përditshëm që mund të ekspozohen në pajisje ngjitur me kioskat dhe jo të fiksuara në tokë.
3. Është i detyrueshëm afishimi i çmimeve të shitjes. Tregtari në mënyrë të dukshme duhet të afishojë etiketat e çmimeve të mallrave të ekspozuara për shitje.
4. Tregtimi i artikujve ushqimorë i nënshtrohet mbikëqyrjes dhe kontrollit të autoriteteve shëndetësore.
5. Pastrimi i brendshëm i kioskës dhe i ambientit përreth në një sipërfaqe 2 m² përreth saj do të kryhet nga subjekti që ushtron aktivitetin menjëherë pas mbylljes sipas orarit të caktuar në lejen e lëshuar nga Bashkia Shkodër.
6. Orari tregtimit në kioska kërkohet nga subjekti gjatë aplikimit dhe miratohet në leje dhe mund të jetë edhe 24 orëshe.
7. Në asnjë rast nuk duhet të hedhin përtokë mbeturina apo mbetje të çfarëdo lloji, por duhet t'i grumbullojnë ato në vendet e caktuara për këtë qëllim.
8. Garantimin e minimumit të lëvizshmërisë së këmbësorëve me një distancë prej 3.00 m nga fasada e objektit tek pajisja/fasada e kioskës.

KREU V - Elementet e fasadave të bazës së ndërtesave (Tabelat Identifikuese, Tabelat reklamuese , Reklammat, Elementet teknike dhe BillBoards)

Neni 51 - Kriteria të përgjithshme mbi vendosjen e tabelave identifikuese dhe reklamave

1. Lejohet që subjekti të vendosë pajisje publicitare (tabela identifikuese, reklama) vetëm pasi ai të jetë pajisur me lejen/autorizimin përkatës të lëshuar nga Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Shkodër.
2. Tabelat identifikuese duhet të vendosen paralele me faqen e fasadës, në varësi të konfigurimit arkitektonik të objektit dhe këto në asnjë rast nuk duhet të kenë dalje më shumë se 50cm nga fasada.
3. Në rastet e bizneseve madhore si hotele, shkolla, klinika etj; tabelat identifikuese mund të vendosen vertikalisht, perpendikular me fasadën. Vendosja e tyre është e diskutueshme dhe varet nga karakteristikat specifike të zonës. Projekti teknik i propozuar duhet të përmbajë në menyre të detajuar dimensionimin në raport me fasadën.
4. Projektimi i logove në mur duhet bërë në më shumë se 30cm mbi rrugën e këmbësoreve dhe projektimi i çdo logoje tjetër në më pak se 300cm mbi ngritjen e rrugës. Nuk lejohet projektimi i logove të tokës përtej vijës së rrugës
5. Nuk lejohet të ngjitet logoja pranë daljes së emergjencës/ shkalleve të jashtme / slide-doors / dritareve ose të hapurave nga e cila vjen drita / ventilimi.
6. Nuk lejohen logo të ndriçuara në vende të caktuara të kufizuara.
7. Nëse vendosja e tabelave identifikuese dhe reklamave shoqërohet edhe me vendosjen e tendave me strehë, sipas nenit 18, tabelat duhet të vendosen në pjesën e poshtme të tendës. Lejohet që tenda të ketë logo identifikuese apo reklama në ekstremin e poshtëm të tendës me një madhësi të rregullt dhe të harmonizuar.
8. Elementet e Tabelave Reklamuese (*Billboards*) , procedura e vleresimit/miratimit të elementeve të strukture shqyrtohet përmes platformes e-leje nga Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në zbatim të kriterëve ligjorë të VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” sipas kriterëve të lejuara mbi distancat , regjimin kadastral , pronesine publike apo private, të drejtat e bashkepronesise etj.
9. Në rastet se këto elemente (*Billboards*) propozohen të vendosen në sipërfaqe publike (ku nuk cenohen elementet urban , levizshmëri, aksesueshmëri , ose që pozicionohen në rastet përjashtimore në këto rregullore) , realizohen në baze të një kërkesë të subjektit që kërkon/shpreh marrjen e angazhimit të investimit të këtij instalacioni.
10. Zbatimi i pikës 9 të kreut V , realizohet vetëm në arritjen e një marrëveshjeje me bashkinë Shkodër referuar kërkesës së subjektit.
11. Njesia Vendore mund të parashikojë dhe planifikojë dhe me fondet e saja vendosjen e këtyre të elementeve (*Billboards*) .
12. Në rastin e vendosjes së këtyre instalacioneve (*Billboards*) paraprakisht Bashkia Shkodër për gatit një plan nga ku të evidentojë të gjitha pikat/pozicionet e favorshme (në bapsira

publike) mbeshtetur ne ligjin e pronave te shtetit dhe ligjit te transferimit te pasurive publike ne njesite e qeverisjes vendore , nga ku miraton harten e lejuar te ketyre pozicioneve në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, nisur nga nevoja dhe domosdoshmëria e ofrimit të ketij shërbimi .

Neni 52 - Afati, dokumentacioni dhe procedura aplikimit

1. Afati maksimal i autorizimit është 1 vjeçar (ndersa per *Billboards*) ky afat eshte 2 vjeçar).
2. Subjekti i interesuar duhet të paraqesë kërkesën sipas platformes “eleje” për vendosjen e reklamës sipas dispozitave ligjore te nenit 7 “Punime që kryhen me deklarata paraprake punimesh” pika 3 germa “ix” e VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”.
3. Subjektet aplikues, përveç dokumentacionit administrativ, duhet t’i përmbahen rregullave për plotësimin e dokumentacionit si më poshtë:
Për rastet e tabelave identifikuese/reklamave paralele me fasadën kërkohet:

- a) Formulari i deklaratës, sipas formatit të përcaktuar në sistemin elektronik të lejeve, dhe, sipas rastit:”.
- b) Dokumenti që vërteton pronësinë apo të drejtat e ligjshme të deklaruesit mbi pasurinë në të cilën kryhen punimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi, përfshirë kontratë sipërmarrjeje/porosie, e të ngjashme;
- c) Projekti teknik i realizimit të punimeve, i firmosur nga projektues të licencuar perfshire dhe deklaratat e pergjegjesive profesionale.
- d) Vërtetimi i pronësisë së rifreskuar për 3 muajt e fundit prane Agjencise Shteterore se Kadashtres.
- e) Foto te gjendjes ekzistuese

Për rastet e tabelave identifikuese/reklamave vertikalisht, perpendikular me fasadën kërkohet:

- a) Formulari i deklaratës, sipas formatit të përcaktuar në sistemin elektronik të lejeve, dhe, sipas rastit:”.
- b) Dokumenti që vërteton pronësinë apo të drejtat e ligjshme të deklaruesit mbi pasurinë në të cilën kryhen punimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi, përfshirë kontratë sipërmarrjeje/porosie, e të ngjashme;
- c) Projekti teknik i realizimit të punimeve, i firmosur nga projektues të licencuar perfshire dhe deklaratat e pergjegjesive profesionale.
- d) Vërtetimi i pronësisë së rifreskuar për 3 muajt e fundit prane Agjencise Shteterore se Kadashtres.
- e) Foto te gjendjes ekzistuese
- f) Renderat të jenë të qarta, ku të pasqyrohen veçmas pamje ballore dhe anësore.

4. Afati i shqyrtimit të kërkesës nga Drejtoria e Kontrollit te Territorit ne Bashkinë Shkodër është sipas afateve te percaktuara ne VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”i ndryshuar .

Neni 53 - Krite mbi vendosjen e elementeve teknike

1. Njësitë e jashtme të kondicionimit konsiderohen si elemente të papëlqyeshme për fasadën.

2. Në rastet e objekteve ekzistuese njësitë e kondicionimit, duhet të vendosen të fshehura në ballkone, lozha, etj. Në rastet kur është e pamundur fshehja e tyre me elementet ekzistuese të ndërtesës, këto duhet të vendosen në fasadat dytësore larg fasadave kryesore përgjatë rrugëve. Në asnjë rast kondicionerët nuk duhet të jenë të mbështetura në trotuar apo sipërfaqe publike.
3. Në rastet e objekteve të reja, montimi dhe vendosja e kondicionerëve duhet të jetë e parashikuar në projekt, në mënyrë të tillë që të mos ketë ndikim negativ në fasadën e ndërtimit.

KREU VI - PËRDORIMI I HAPËSIRËS REKLAMUESE (CITY LIGHTS DHE TABELAT REKLAMUESE LED)


Neni 54 - Leja dhe procedurat e dhënies së lejes

1. Ky kre përcakton rregullat për mënyrën e zënies/përdorimit të hapësirave publike nga subjektet që ushtrojnë aktivitete reklamuese ose që synojnë të reklamojnë biznesin e tyre në hapësira publike për (*City Lights*) dhe (*Tabelat Reklamuese Led*).
2. Subjekti që kërkon të shfrytëzojë hapësirën publike në funksion të reklamimit, duhet të realizojë kerkese pranë Z1N për propozimin e vendosjes së ketyre instalacioneve, nga ku duhet t'i përmbahet disa rregulla për plotësimin e dokumentacionit teknik, me qëllim arritjen e marreveshjes me Bashkinë Shkodër, të përcaktuar në formularin e aplikimit pranë Z1N :
 - a) Planimetri, planvendosje dhe pamje për secilën tabelë. Këto duhet të jenë të punuara, të firmosura e vulosura nga persona të licencuar në këtë fushë dhe t'u përmbahen rigorozisht parametrave të vendosura në vijim;
 - b) Renderat do të jenë të qarta dhe në to duhet të jenë të pasqyruara veçmas pamja ballore, pamjet anësore.
3. Subjekti që kërkon të shfrytëzojë hapësirën publike në funksion të reklamimit, duhet të pajiset me lejen/miratimin përkatës të lëshuar nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit dhe të përbyllë procedurën e faturimit nga Drejtoria e Tarifave dhe Taksave Vendore.
4. Për këtë kategori aktiviteti, afati i lejes për zënie të hapësirës publike është 2 vjeçar.
5. Në rastin kur subjektet që pajisen me leje për zënie/përdorimin e hapësirës publike për vendosjen e Tabelave Reklamuese Led dhe bashkëpunojnë me Bashkinë Shkodër sipas marreveshjeve perkatese, duke ofruar për këtë institucion reklama dhe mesazhe sensibilizuese, promovuese të eventeve në qytet, informimit në shërbim të komunitetit dhe publikut, mund të përjashtohen apo do i krijohen lehtësira nga pagesa e tarifës.
6. Subjekti është i detyruar të sigurojë lidhje me energjinë elektrike në bashkëpunim me OSHE dhe të mos jetë i lidhur me rrjetin elektrik të ndriçimit rrugor.
7. Përjashtimi nga pagesa e tarifës/detyrimeve përcaktohet në marrëveshjen e nënshkruar nga Bashkia Shkodër/Drejtoria e Tarifave dhe Taksave Vendore, në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellta të palëve.

Neni 55 - Dimensionet dhe distancat

1. City Lights duhet të kenë një formë drejtkëndore dhe të jetë me dimensione: 1.2 m i gjerë dhe 1.8 m i lartë, jo më shumë se 40 cm i trashë.
2. City Lights përdoren vetëm për reklamim/informim nëpërmjet posterave me tekste dhe imazhe. Nuk lejohet të përdoret për qëllime të tjera.
3. City Lights duhet të jenë të vendosur pingul ose horizontal me trupin e rrugës, fill pas bordurës që ndan trupin e rrugës me trotuarin, duke lënë të lirë zonën lëvizëse në trotuar dhe korsinë e biçikletave (nëse ka).
4. Lejohet vendosja e City Lights vetëm në ato raste kur trotuari apo hapësira publike e vendosur është jo më pak se 3.5 m e gjerë duke filluar nga bordura e trotuarit deri tek Fasada e objektit dhe duke lënë minimum 2 m për zonën lëvizëse, pa përfshirë zonën e Frontazhit të përdorur nga subjektet tregtare, nëse ka. Në këtë përlllogaritje nuk përfshihet në asnjë rast korsitë e biçikletave (nëse ka) apo elementë të tjerë përbërës të trupit të rrugës.


5. City Lights duhet të vendoset në një rreze prej të paktën 2.5 m larg çdo elementi urban që e kufizon si p.sh pemë, kosh plehrash, ndriçues urban, sinjalistikë rrugore, hidrant etj dhe 10 m larg semaforëve dhe rampave.
6. City Lights duhet të kenë një distancë prej të paktën 70 m njëri- tjetri, kur trotuari është i vazhdueshëm e nuk ka ndërprerje me rrugë.





KREU VII – PARKIMET E AUTOMJETEVE

Neni 56 - Kriteria mbi Parkimet e Rezervuara të automjeteve

1. Bashkia Shkodër në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, miraton hartën e parkimeve (zonave të lejuara) që mund të rezervohen në hapësirën publike të qytetit në aktet e miratuara nga Kryetari i Bashkisë. Vendndodhja e tyre mund të përcaktohet edhe në Planet e Lëvizjes së Qëndrueshme Urbane, në Planet e Detajuara Vendore ose në dokumentat e tjera të planifikimit që miratohen nga strukturat përgjegjëse, në përputhje me akte ligjore dhe nënligjore që normojnë zhvillimin dhe planifikimin e territorit.
2. Sinjalistika vertikale e parkimit duhet të ketë një tabelë vertikale me logon “P” të bardhë një katror blu, me emrin e subjektit, ditët dhe orarin përkatës. Tabela duhet të ketë përmasat 50 x 80cm dhe të jetë e vendosur në lartësinë 200 cm nga niveli i trotuarit. Pozicionimi i fiksimit në terren duhet të jetë 60 cm nga bordura e trotuarit.
3. Sinjalistika horizontale duhet të jetë vijëzimi me të verdhë ku vija të jetë me trashësi 10 cm.
4. Orarai i rezervuar të jete minimalisht 8 ore dhe i pa ndare në fasha orare. Fashat oraret të cilat do jete pjesë e kërkesës së subjekteve/individëve propozohen të jete :
 - a) 08.00-16.00
 - b) 16.00-24.00
 - c) 00.00-08.00
5. Fashat orare e propozuara sipas pikes 4 nuk janë kushtezuese por detyruesisht duhet të jenë të pandara në 8 ore.
6. Elementet (tabelat të cilat do vendosen), vijëzimi kostot merren në ngarkim nga subjekti/individ i cili kërkon vendrezervimin sipas specifikimeve të mëposhtme në bashkepunim dhe monitorim të Ndërmarrjes së Sherbimeve të Punëve Publike.
7. Në tabelen ilustruese të parkimit nuk lejohen reklama apo shënime të tjera veç atyre të përcaktuara ku përfshihen ditët , orarin , emrin e subjektit dhe numrin e vendeve.
8. Kategoria e automjeteve të cilat lejohen për parkim të rezervuar janë automjetet (autovetura).






KREU VIII – PARKIMET E BIÇIKLETAVE

Neni 57 - Kritere mbi vendosjen e Parkimeve të Biçikletave

1. Në këtë kre të rregullores përcaktohen rregullat për vendosjen e parkimeve të biçikletave në hapësirat publike të Bashkisë Shkodër.
2. Parkimet e biçikletave duhet të jenë të parafabrikuar dhe me strukturë të qëndrueshme, por të cilat në asnjë rast nuk duhet të dëmtojnë hapësirën publike në të cilat vendosen dhe hapësirën përreth saj.
3. Parkimet e biçikletave duhet ti përmbahen me përpikmëri modelit, dimensioneve dhe materialeve të përcaktuara në Aneksin A. Në rastin e subjekteve në afërsi të njeri-tjetrit që kërkojnë të vendosin parkime, ato do të grupohen dhe vendosen në seri me njëri-tjetrin.
4. Nuk lejohet vendosja e asnjë elementi reklamues parkimet e biçikletave.
5. Parkimet e biçikletave duhet të jenë me përdorim të lirë publik, pavarësisht subjektit që merr autorizimin dhe i vendos ato.
6. Parkimet e biçikletave lejohen vetëm në rastet e trotuareve me elementeve urbane (pemë, stola etj) me gjerësi të trotuareve jo më të vogël se 4.50m. Struktura e parkimit nuk duhet të kalojë limitin 1.5m nga bordura e trotuarit. Parkimi bashkë me biçikletat nuk duhet të kalojnë limitin 2.0m nga bordura e trotuarit, në mënyrë të tillë që të sigurohet në çdo rast që edhe në pikun e përdorimit të mos cenohet zona lëvizëse prej 2.5m e trotuarit



Neni 58 - Autorizimi dhe procedura e dhënies së tij

1. Çdo subjekt apo individ që kërkon të vendosë parkim bicikletash përpara njësisë së tregtimit duhet që të pajiset me një autorizim të lëshuar nga Bashkia Shkodër.
2. Çdo parkim bicikletash i vendosur pa autorizimin përkatës të Bashkisë Shkodër do të konsiderohet shkelje dhe mbi subjektin do të merren masa ndëshkuese.
3. Subjekti i interesuar duhet të paraqesë kërkesën pranë Z1N , ku duhet të ketë bashkangjitur:
 - a) Plan vendosjen e Propozuar
 - b) Foto ekzistuese
 - c) Vërtetimin e QKR
4. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin e përcaktuar në formularin e aplikimit pranë Z1N .
5. Afati i shqyrtimit të kërkesës nga Bashkia Shkodër është 15 ditë nga data e marrjes së aplikimit.

KREU IX - DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 59 - Strukturat zbatuese

Strukturat e ngarkuara për zbatimin e kësaj rregullore në lidhje me lejet për shfrytëzimin e hapësirës publike, si dhe mbrojtjen dhe garantimin e përdorimit të hapësirës publike janë:

1. Kryetari i Bashkisë ose organi autorizues për lejet/miratimet e përcaktuara në këtë Rregullore.
2. Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Te territorit organi autorizues per percaktimin e planeve te vendosjeve se ushtrimit te aktiviteteve sipas kesaj rregullore.
3. Drejtorja e Kontrollit dhe Zhvillimit Te territorit organi autorizues per miratimin lejeve te cilat perfshihen ne dispozitat ligjore të VKM 408/2015 i ndryshuar.
4. Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkisë Shkodër – organ inspektues në lidhje me shlyerjen e detyrimeve për pagesën e tarifës për zënien e hapësirës publike, sipas vendimit nr. 59, datë 30.12.2015 të Këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë e Shkodrës” (i ndryshuar). Për këtë qëllim vendos e zbaton sanksionet për shkelje të detyrimeve fiskale vendore në bazë të nenit 4, pika 2 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar).
5. Policia Bashkiake – organ inspektues për respektimin e kushteve të përgjithshme të lejeve të dhëna nga organet autorizuese. Për këtë qëllim vendos e zbaton sanksionet në bazë të kësaj rregulloreje, dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Policia Bashkiake mbështet gjithashtu inspektorët e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore në bazë të nenit 4, pika 3 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), nëse do të jetë e nevojshme.
6. Ndërmarrja e Sherbimeve Publike organ inspektues sipas akteve nënligjore që normojnë këtë proces mund të llogarisin demin ose kanë të drejte ti inspektojnë në raste konstatimi të shkeljeve , por për kontratat /lejet/autorizimet ndjekjen ne lidhje me zbatimin e tyre eshte kompetente struktura qe i ka leshuar atë.

Neni 60 - Njësia monitoruese

1. Pranë Bashkisë Shkodër kryen rolin e njësisë monitoruese Policia Bashkiake në lidhje me autorizimet/kontratat/lejet e lëshuara për ushtrimin e aktivitetit në hapësirën publike.
2. Në rolin e njësisë monitoruese, Policia Bashkiake ndjek zbatimin e kësaj rregulloreje dhe akteve të tjera në fuqi nga strukturat zbatuese dhe ato inspektuese, duke raportuar një herë në 3 muaj para Kryetarit të Bashkisë, apo sa herë që kërkohet nga ky i fundit.
3. Njësia monitoruese evidenton rastet kur strukturat zbatuese veprojnë në kundërshtim me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në këtë rregullore dhe njofton Kryetarin e Bashkisë për marrjen e masave në lidhje për sa më sipër, përfshirë këtu dhe nxjerrjen e akteve të nevojshme.

Neni 61 - Dispozita kalimtare

Subjektet që ushtrojnë aktivitet në hapësirat publike në territorin e Bashkisë Shkodër, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje të marrin masat për ushtrimin e aktivitetit në përputhje me kushtet dhe kriteret e vendosura në këtë rregullore.

Neni 62 - Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.





Neni 62 - Hyrja në fuqi
Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

LIDHJA A



Neni 1 - Përcaktime mbi çadrat e diellit që lejohen

Format e Lejuara te Çadrave:


Tipi 1 – E varur, me krah



Tipi 2 – E varur dopio, me krah T



Tipi 3 – E varur dopio, me krah V



Ngjyrat e lejuara te Strukturës së Çadrës:

RAL 9010



Antracite




Ngjyre Druri

Ngjyrat e lejuara te Pëlhurës së Çadrës:

1 – Bardhe



2 – Pana



3 – Gri e Erret



4 – Gjelbër





5 - Kuqe Bordeaux



Shembuj Çadrash te Lejuara qe plotësojnë Kërkesat:





Neni 2 - Përcaktime mbi tendat me strehë dhe tendat diellore që lejohen

Materialet e Strukturës duhet të jenë prej druri, hekuri dhe/ose alumin i ngjyrosur; me ngjyrat si më poshtë:

RAL 9010



Antracite



Ngjyre Druri

Materialet e tendës duhet të jenë pëlhurë beze, pëlhurë akrilike, pvc; me ngjyrat e lejuara si më poshtë:


1 – Bardhe



2 – Pana




3 – Gri e Erret



4 – Gjelbër



5 - Kuqe Bordeaux



Neni 3 - Përcaktime mbi saksitë/vazot dhe elementet kufizuese që lejohen

Vazo Metalike: Ngjyrat e lejuara



Ngjyre - Zi



Ngjyre - Cor-ten



Gjelber - RAL 6011





Kuq - RAL 3005

Vazo Betoni: Ngjyrat e lejuara



Me pigment të
Bardhe


Fiksimi me Bulona ose me mbështetje te lire






Vazo metalike drejtkëndore: 100x60x50cm


Pamje Ballore




Pamje Anesore



Pamje Siper




Aksonometri




Vazo metalike drejtkëndore: 200x60x50cm


Pamje Ballore




Pamje Anesore



Pamje Siper




Aksonometri




Vazo metalike cilindrike: 80x60x60cm


Pamje Ballore




Pamje Anesore



Pamje Siper




Aksonometri






Vazo betoni drejtkëndore: 200x60x50cm


Pamje Ballore




Pamje Anesore




Prerje Gjatesore




Prerje Terthore



Pamje Siper




Aksonometri




Neni 4 - Ekspozitorë produktesh ushqimore

Tipi 1





Materiali: Strukturë metalike me ngjyrë të zezë (Ral 9005), me seksion rrethor 1.5 x 1.5 cm. Arka druri për vendosjen e produkteve.
Dimensionet: lartësia 120 cm, gjatësia 55cm, gjërësia 32cm.

Tipi 2



Materiali: Strukturë metalike me ngjyrë të zezë (Ral 9005), me seksion rrethor 1.5 x 1.5 cm. Arka druri për vendosjen e produkteve.
Dimensionet: lartësia 120 cm, gjatësia 110 cm, gjërësia 32cm.

VENDQENDRIM PËR BIÇIKLETA - MODEL A



VENDQENDRIM PËR BIÇIKLETA - MODEL A

